

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN –Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues, Islam Thaçi, me sekretaren juridike Rafete Syla, si procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të pandehurit, A. L , për shkak të veprës penale, rrezikimi i trafikut publik , nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës, PP.II.nr. 1971/15 i dt. 17.12.2015, të cilën e përfaqëson prokurorja e shtetit Kujtesa Fazliu, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar më datën 20.04.2017 , shpalli publikisht ndërsa më dt. 05.05.2017 hartoi këtë :

A K T G J Y K I M

I pandehuri **A. L.** , nga babai I , nëna A. e lindur H i lindur më dt. ..në Gjilan , tani me vendbanim në Gj. rr. , ka të kryer shkollën fillore , i punësuar , i pa martuar , i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i R. të Kosovës, më parë i pa dënuar si dhe nuk udhëhiqet procedurë ndaj tij.

Ë s h t ë f a j t o r

Sepse më 10.10.2015 , rreth orës 08,10 , në Gjilan, në rrugën “....” përkatësisht tek semaforët, i pandehuri derisa ka qenë duke drejtuar automjetin e markës “...”, ngjyrë e bardhë, me tabela të regjistrimit...., ka rrezikuar trafikun publik duke vënë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë e tyre, në atë mënyrë që me pjesën e përparme të automjetit të tij, e në kundërshtim me dispozitën ligjore nga neni 54,1 të ligjit mbi sigurinë e komunikacionit rrugor, e godet nga mbrapa automjetin e markës “”, me tabela të regjistrimit...., të cilin e drejtonte A.R i cili në atë moment ishte i ndalur për të pritur sinjalizimin e semaforit, me ç’rast shkaktohet aksidente i komunikacionit në të cilin aksident përpos dëmit material në këto automjete, lëndime të lehta trupore pëson pasagjeri A. R i cili për shkak të lëndimeve të pësuar, detyrohet të kërkoj ndihmë mjekësore në Spitalin Regjional të Gjilanit – Qendra Emergjente.

Me çka ka kryer veprën penale , rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve: 4, 41, 49 50, 51, 52, 73, 74, 75 dhe 76 të KPRK si dhe nenit dhe 365 të KPPK-ës, të pandehurit , i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që të pandehurit A. L , i shqiptohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 90(nëntëdhjete) ditëve , i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afat prej 1 viti , nuk kryen vepër tjetër penale . në të kundërtën dënimi me kushte ka për t’iu revokuar.

Detyrohet i pandehuri që të paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të bëhet I formës së prerë.

I dëmtuari për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

PTHDP në Gjilan ka paraqitur aktakuzën PP.II.nr. 1971/15 i dt. 17.12.2015, kundër të pandehurit , për shkak të veprës penale, rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar dhe publik në të cilën ka prezantuar prokurori i shtetit Kujtesa Fazliu , i pandehuri, ndërsa i dëmtuari i njëjti ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt por nuk ka prezentuar.

Prokurorja e shtetit pas leximit të aktakuzës në tërësi ka mbetur pranë pretendimeve të theksuara si në dispozitivin e së njëjtës, duke i propozuar gjykatës që të njëjtin ta shpallë fajtor dhe ti shqiptoi dënimin meritor në pajtim me Kodin Penal.

I pandehuri pasi që u njoftua me aktakuzën përkatësisht veprën penale e cila i vihet në barrë, i njëjti deklaroi se e pranojë fajësinë për veprën penale të cilën ma vënë në barrë aktakuza .

Me që i pandehuri në shqyrtimin e sotëm fillestar vullnetarisht e pranojë fajësinë gjykata konstatoi se janë përmbushur të gjitha kërkesat për pranimin e fajësisë konfirmo nenit 248 ,të KPPK-ës , andaj gjykata nuk vazhdoi me administrimin e provave.

Prokurorja e shtetit Kujtesa Fazliu , në fjalën përfundimtare deklaroi: duke u bazuar në faktin se i pandehuri , e ka pranuar veprën penale e cila i vihet në barrë sipas kësaj aktakuze edhe pas njoftimit të kësaj gjykate , lidhur me pasojat dhe bëni fitet e pranimit të fajësisë , mbetem në tërësi pranë kësaj aktakuze dhe kërkoj nga gjykata që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënoj me dënim sipas ligjit.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ,i propozoj gjykatës që të ketë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale , rrezikshmërinë shoqërore si dhe lëndimet e lehta të shkaktuara të dëmtarit ,me rastin e kryerjes së kësaj vepre penale.

I pandehuri , në mbrojtjen e vet ka deklaruar : e pranojë fajësinë për veprën penale me të cilën ngarkohem , pendohem për të njëjtën, i kërkoj falje të dëmtuarit , e njoftoj gjykatën se deri te aksidenti ka ardhur nga pakujdesia dhe jo me qëllim timin, kërkoj nga gjykata që brenda mundësive ligjore të më shqiptojë një dënim sa më të butë.

Duke u bazuar në aktakuzë , përkatësisht veprën penale me të cilën ngarkohet i pandehuri si dhe pranimin e fajësisë , gjykata vërtetoi se te i njëjti qëndrojnë të gjitha elementet e kryerjes së veprës penale , rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378 paragrafi

6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së , andaj të njëjtin, gjykata e shpalli fajtor dhe i shqiptoj dënime me kusht si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së dënimit me kusht ndaj të pandehurit, gjykata i ka marrë parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit ,ku si rrethana lehtësuese ka marr për bazë, pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, sjelljen korrekte në gjykatë, pendimin për kryerjen e veprës penale ,kërkim faljen të dëmtarit si dhe premtimin se në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm gjatë ngasjes së automjetit si dhe premtimin se nuk do të kryej vepra të kësaj natyre .

Ndërsa si rrethana rënduese gjykata mori parasysh shkallën e përgjegjësisë penale, rrezikshmërinë shoqërore si dhe lëndimet e lehtë të shkaktuar a të dëmtuarit.

Sipas bindjes së kësaj gjykate dënimi me kusht, sipas dispozitivit të këtij aktgjykimi është i drejtë në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit , dhe konsideron se edhe me këtë dënim me kusht do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPRK-ës, si dhe ky dënim do të ndikoj në të pandehurin dhe personat tjerë, që në të ardhmen të jenë më të kujdesshëm gjatë ngasjes së automjetit.

I dëmtuari , konform nenit 463 të KPPK-ës për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike e udhëzon në kontest civil.

Për shpenzimet e procedurës , gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 453 par. 1 e lidhur me nenin 450 par. 1 nëpar. 2.6 të KPRK-ës .

Nga të cekurat më lartë , është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i përgjithshëm
Më 05.05.2017

Sek. Juridike
Rafete Syla ,d.v.

Gjyqtari i vetëm gjykues
Islam Thaçi, d.v.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi , mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, departamenti i përgjithshëm në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga data e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje te mjaftueshme i dorëzohet kësaj gjykate .